

Vendim nr. 100 datë 10.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 10.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Dh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DHIONISIOS ALFRED BELERI**, përfaqësuar nga avokate Klodiana Gjyzari, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve datë 10.05.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; nr. 42, datë 12.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; nr. 104 (87-2023-157), datë 10.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2023-1531, datë 26.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 18, 36, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 6, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 08.05.2023 oficerët e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së qarkut Vlorë kanë bërë kallëzim për aktivitetin kriminal të disa shtetasve në fushën e shitblerjes së votës për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023. Për këtë arsye, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*Prokuroria Vlorë*) ka regjistruar procedimin penal nr. 489/2023 për konstatimin e kryerjes së veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal (*KP*).

2. Në referimin penal, oficerët e Policisë Gjyqësore kanë pretenduar se ndër personat e dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të parashikuar nga neni 328 i KP-së është edhe kërkuesi, i cili, sipas tyre, në bashkëpunim me persona të tjerë, jepte shuma në vlera monetare dhe i shpërndante ato kundrejt premtimit për votë nga shtetas të ndryshëm në Njësinë Administrative Horë-Vranisht dhe fshatrat që përmbledh kjo njësi administrative.

3. Në datën 08.05.2023 Prokuroria Vlorë ka vendosur krijimin e grupit hetimor për hetimin e këtij kallëzimi penal dhe po në të njëjtën datë, në orën 13:00, Drejtoria e Policisë Vendore Vlorë ka kërkuar në Prokurorinë Vlorë autorizimin e lejimit të përgjimit ambiantal dhe atij të fshehtë fotografik, filmik, audio dhe video në vende publike për shtetasit e dyshuar në kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të parashikuar nga neni 328 i KP-së, ndër të cilët ka qenë edhe kërkuesi.

4. Me autorizimin e datës 08.05.2023 “Për vëzhgimin dhe regjistrimin në vende publike”, Prokuroria Vlorë ka vendosur: “Autorizimin e vëzhgimit dhe regjistrimit të fshehtë fotografik, filmik ose me video në vende publike të veprimtarisë së personave të dyshuar si të përfshirë në kryerjen e veprës penale dhe personave të tjerë që mund të jenë të pranishëm me këta shtetas gjatë kryerjes së veprimtarive të paligjshme”. Gjithashtu, Prokuroria Vlorë në vendimin e saj ka disponuar që veprimet e mësipërme të vijojnë nga data 08.05.2023 deri në datën 22.05.2023 dhe të ekzekutohen nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe të strukturave të tjera të posaçme.

5. Në datën 08.05.2023, në orën 15:00, rezulton se grupi hetimor pranë Prokurorisë Vlorë ka nxjerrë vendimin “Për lejimin e përdorimit të metodës speciale të hetimit për veprimet simuluese dhe për lejimin e vëzhgimit”. Për realizimin e këtij veprimi hetimor ka pasur kërkesë nga Policia Gjyqësore, ku kërkohet, sipas nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), autorizimi i prokurorisë për zhvillimin e veprimit hetimor të simulimit përmes një prej

burimeve të të dhënave të referimit penal, konkretisht shtetasit A.R. Në zbatim të këtij veprimi hetimor është hartuar akti procedural “Marrëveshje” i datës 08.05.2023, ndërmjet prokurorëve të grupit hetimor dhe shtetasit A.R., personi i autorizuar për të kryer veprimet e simuluar.

6. Në datën 10.05.2023, pa përcaktuar orën, Prokuroria Vlorë (dy prokurorët e grupit hetimor) ka vendosur: “Regjistrimin e fshehtë fotografik, filmik ose me video në vende private të shtetasit A.R. dhe të personave të tjerë që mund të jenë të pranishëm me të; përgjimi ambiental të kryhet për një periudhë katërditore, e cila do të fillojë nga data 10.05.2023 deri në datën 14.05.2023; përgjimi ambiental të shoqërohet me pamjet video të komunikimeve të shtetasit A.R. dhe me dëgjimin audio të bisedave që do të zhvillohen në ambiente private.”. Në vendim argumentohet nga prokurorët se koha në të cilën zhvillohet takimi dhe e kryerjes së përgjimit ambiental e bën të pamundur objektivisht paraqitjen e kërkesës në gjykatë për lejimin e përgjimit dhe se një vonesë e tillë mundet t’i sillte dëme hetimit, duke humbur aktualiteti dhe mundësia e zbulimit të të dhënave provuese, të cilat në një moment të mëvonshëm do të ishin të pamundura.

7. Në datën 11.05.2023, Prokuroria Vlorë ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë “Kërkesë për vleftësimin dhe lejimin e përgjimit ambiental”, të autorizuar me vendimin e prokurorit të datës 10.05.2023, me anën e të cilit është urdhëruar përgjimi i fshehtë fotografik, filmik, me audio ose me video i personave në vende private të shtetasit A.R. dhe të personave të tjerë që mundet të jenë në prani të këtij shtetasi. Në këtë kërkesë është argumentuar se ajo dhe vendimi për përgjim bazohen në nenet 221 dhe 222 të KPP-së, të lidhur me nenin 75/a të këtij kodi, si dhe në nenin 328 të KP-së. Gjithashtu, në kërkesë është kërkuar edhe vleftësimi i ligjshëm i vendimit të datës 10.05.2023.

8. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 42, datë 12.05.2023, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Vleftësimin e ligjshëm të vendimit të prokurorit të datës 10.05.2023. Urdhërimin e transkriptimit të plotë të regjistrimeve të kryera. Shtyrjen e afatit të depozitimit në sekretari të rezultateve të këtij përgjimi deri në përfundimin e hetimeve paraprake [...]”. Në vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, referuar fakteve të çështjes dhe nenit 222 të KPP-së, prokuroria ka pasur arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa e kryerjes së veprimeve hetimore, siç është edhe përgjimi, mund t’i vijë një dëm i rëndë hetimeve paraprake, ndaj rrjedhimisht kërkesa e prokurorit për realizimin e veprimeve të përgjimit, me anë të vendimit të datës 10.05.2023, duhet pranuar si e bazuar në kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 222, pika 2, i KPP, dhe gjykata është njoftuar brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, pikërisht me kërkesën e paraqitur në datën 11.05.2023. Po sipas gjykatës së shkallës së parë, referuar parashikimeve të nenit 221 të KPP-së, në rastin konkret vepra penale

e parashikuar nga neni 328 i KP-së, për të cilën akuzohet kërkuesi, parashikon dënim me burgim deri në pesë vjet dhe është vepër penale e parashikuar nga neni 75/a i KPP-së, duke u plotësuar në këtë mënyrë kriteri i parashikuar në këtë dispozitë.

9. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin e datës 29.05.2023, ka vendosur dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*). Kjo e fundit, me vendimin nr. 104 (87-2023-157), datë 10.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 12.05.2023 të gjykatës të shkallës së parë. Sipas GJKKO-së së Apelit, gjykata e shkallës së parë ka respektuar elementet e nenit 222 të KPP-së, duke shqyrtuar rregullisht dhe efektivisht kërkesën e prokurorisë. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vlerësuar se edhe nga organi i akuzës janë zbatuar drejt kushtet ligjore procedurale të pikës 2 të nenit 222 të KPP-së, dhe se pretendimet e kërkuesit për mosrespektimin e pikave 1 dhe 3 të nenit 221 të KPP-së dhe pikës 1 të nenit 222 të KPP-së janë të pabazuara dhe duhet të rrëzohen.

10. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1531, datë 26.09.2023, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Ndaj këtij vendimi në datën 11.10.2023 kërkuesi, nëpërmjet mbrojtëses së tij, ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se është cenuar:

11.1. *E drejta e jetës private në drejtim të lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës*, e parashikuar nga neni 36 i Kushtetutës, për shkak se vendimi i Prokurorisë Vlorë i datës 10.05.2023 është marrë në shkelje të neneve 221 dhe 222 të KPP-së. Në rastin konkret nuk rezulton që në momentin e marrjes së vendimit nga Prokuroria Vlorë në këtë procedim të ketë pasur “të dyshuar”, si dhe nuk rezulton që në ngarkim të kërkuesit ekzistonte një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale. Emrat e personave të cilëve u atribuohet vepra penale janë regjistruar në datën 12.05.2023, pra pas momentit të regjistrimit të veprës penale. Kur prokuroria ka marrë vendimin e përgjimit në datën 10.05.2023, procedimi penal ka qenë pa emër subjekti të dyshuar apo nën hetim. Në rastin konkret provohet se kërkuesi është regjistruar si i dyshuar për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar në datën 12.05.2023. Në datën 10.05.2023, kur

është nxjerrë urdhri i përgjimit, ndaj kërkuesit nuk ka pasur asnjë provë. Po ashtu, aktet procedurale, vendimi për lejimin e përgjimit i datës 10.05.2023, kërkesa e prokurorisë e datës 11.05.2023 për vleftësimin e përgjimit dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmbajnë orën e marrjes së tyre, në kundërshtim me nenin 100 të KPP-së.

11.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak se si Prokuroria Vlorë, po ashtu dhe gjykata e shkallës së parë nuk janë kompetente nga pikëpamja lëndore për marrjen e vendimit të përgjimit apo vleftësimin e ligjshëm të tij, pasi vepra penale për të cilën hetohet kërkuesi i përket për hetim dhe gjykim prokurorisë së posaçme dhe gjykatës së posaçme. Mungesa e kompetencës ka ekzistuar që në momentin e regjistrimit të procedimit penal. Ajo nuk ka rezultuar gjatë veprimeve hetimore, siç kanë arsyetuar gjykatat, por që në momentin fillestar. Mungesa e kompetencës lëndore të organit të akuzës sjell si pasojë edhe pavlefshmërinë e çdo veprimi të kryer prej tij. Shqyrtimi i ankimit duhej të bëhej nga gjykata më lartë me ankim të palëve. Ankuesit kanë parashtruar mungesën e kompetencës së GJKKO-së së Apelit për të shqyrtuar ankimin kundër një gjykate që nuk i përket hierarkisë së saj. Neni 278 i KPP-së që në titull parashikon kompetencat e gjykatës së shkallës së parë.

11.3. *Parimi i paanshmërisë*, pasi vendimi i GJKKO-së së Apelit është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të nenit 327/1 të KPP-së, për shkak se vendimi në dhomë këshillimi merret mbi aktet që ndodhen në dosje. Mënyra se si GJKKO-ja e Apelit e ka zhvilluar shqyrtimin e ankimit, sipas një procedure të paparashikuar në ligj, është në shpërfillje të hapur të ligjit procedural penal. Ajo gjykatë ka riçelur hetimin gjyqësor, i cili nuk mund të zhvillohet në dhomën e këshillimit. Anshmëria e gjyqtarit të GJKKO-së së Apelit konstatohet edhe në pjesën që ai ka marrë rolin e Gjykatës, duke shqyrtuar kushtetutshmërinë e nenit 221 të KPP-së dhe duke moszbatuar ligjin dhe Kushtetutën. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 06.09.2023 dhe në datën 15.09.2023 është caktuar për t'u shqyrtuar në dhomën e këshillimit në datën 21.09.2023. Referuar praktikës së asaj gjykate, nuk ka asnjë rast tjetër që ajo të ketë vepruar me këtë shpejtësi. Pas marrjes dijeni për datën e shqyrtimit të çështjes së tij nga faqja e internetit të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues, pasi ai kishte shprehur konsideratë për të njëjtin objekt gjykimi me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.07.2023, si dhe kërkesë për procedurën

e përshpejtimin të gjykimit. Ndërkohë, që kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues nuk u pranua, ajo për përshpejtimin e gjykimit nuk mori përgjigje.

- 11.4. *E drejta e mbrojtjes*, për shkak se kërkesa për vleftësimin e përgjimit është shqyrtuar nga gjykata e shkallës së parë në dhomën e këshillimit pa dijeninë e kërkuarit. GJKKO-ja e Apelit, pavarësisht se ka zhvilluar zyrtarisht tre seanca në dhomën e këshillimit, pavarësisht se ka riçelur një shqyrtim gjyqësor që nuk ishte çelur, ka marrë prova kryesisht, të cilat i ka vetëdebatuar, ka komunikuar me prokurorinë sipas nevojave të çështjes, pa praninë e kërkuarit, nuk e ka parë të arsyeshme t'i kryej këto veprime në seancë publike.
- 11.5. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsytimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me mungesën e kompetencës lëndore, është i pabazuar në aktet e gjykimit. Çështja e kërkuarit duhej të ishte shqyrtuar në seancë publike. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje kërkuarit për zhvillimin e gjykimit në seancë publike. Vendimi i atij kolegji është kontradiktor, pasi në rastin konkret ka shqyrtuar në thelb pretendimet e kërkuarit, duke i konsideruar të pabazuara, sipas nenit 433 të KPP-së, por në përfundim ka vendosur mospranimin e rekursit, i cili parashikohet në nenin 432 të KPP-së. GJKKO-ja e Apelit e mbështet arsytimin e saj te praktika e Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë, e cila sipas nenit 116 të Kushtetutës nuk përfshihet në normat juridike me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë. Kjo shkelje nuk është rregulluar as nga Gjykata e Lartë. Edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i paarsyetur, pasi ajo duhet të ishte më e vëmendshme në arsytimin e saj në lidhje me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm.
- 11.6. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimet gjyqësore nuk kanë zbatuar vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2022 dhe nr. 2/2013 në lidhje me nocionin “person të cilit i atribuohet vepra penale”, “person ndaj të cilit” dhe “i pandehur”. GJKKO-ja nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 3/2015 në lidhje me superioritetin e rregullimit të posaçëm në raport me rregullimin e përgjithshëm. Edhe Kolegji Penal me vendimin e tij ka ndryshuar praktikën e tij në më pak se një vit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Referuar rrethanave të çështjes konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar në këtë Gjykatë vendimet gjyqësore të cilat kanë shqyrtuar ankimin e tij kundër vendimit të Prokurorisë Vlorë “Për regjistrimin e fshehtë fotografik, filmik ose me video të personave në vende private”. Ndërkohë, rezulton se ky i fundit është nxjerrë nga organi i akuzës në kuadër të procedimit penal të nisur ndaj kërkuetit, për të cilin rezulton se ai është ende në gjykim pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë situatë, për të vlerësuar nëse janë shteruar të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i ankimeve, merr rëndësi të përcaktohet nëse vendimet e kundërshtuara nga kërkuesi kanë formë përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, si rregull, individi mund t'i drejtohet asaj për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare për të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar. Megjithatë, duke pasur parasysh edhe natyrën e kontrollit kushtetues individual, si dhe në varësi të rrethanave konkrete të çështjes rast pas rasti, përjashtimisht, kontrollit të saj i nënshtrohen edhe ato vendime të ndërmjetme, karakteri i të cilave do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ky përjashtim zbatohet vetëm nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkëlja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor për kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë Vlorë “Për regjistrimin e fshehtë fotografik, filmik ose me video të personave në vende private”, në kuadër të të cilit janë dhënë edhe vendimet gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi në këtë ankim kushtetues individual, nuk paraqet masën e duhur të autonomisë nga procesi i themelit, i cili është ende në shqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por është në raport ndërvarësie me të, pasi është në funksion të procesit të themelit. Në këtë kuptim, procesi gjyqësor i vënë në lëvizje nga kërkuesi, i përmbyllur me vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, nuk ka natyrë përfundimtare për efekt të gjykimit kushtetues, dhe nuk mund të përfshihet në mënyrë përjashtimore në juridiksionin e kësaj Gjykate, pasi jo vetëm që nuk vendos për të drejtat substanciale të tij, por, nga ana tjetër, as nuk është arritur të provohet se vendimi përfundimtar në lidhje me themelin e çështjes nuk do të ishte i aftë të ndryshonte ose riparonte efektet/pasojat e ardhura nga vendimet e kundërshtuara. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se vetëm pasi të jetë përmbyllur procesi i themelit, që lidhet me themelin e çështjes së kërkuesit, ai mund t'i drejtohet Gjykatës përmes ankimit kushtetues individual.

18. Për sa më sipër në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës dhe se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

19. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.